



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSO

VENDIM I PLOTFUQISHËM
QILLOKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROSEVAC

Më
Data

10. 10. 2018

Numri i lëndës: 2018:014326

Datë: 13.06.2018

Numri i dokumentit: 00060583

Pnr.2580/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, si gjykatë e shkallës së parë penale, me gjyqtarin individual Elmaz Zenuni dhe me sekretaren juridike Liridona Mehmeti-praktikante pran kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit [REDAKTUAR], nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e Ferizajt, për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni 358 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II Nr.1830-7/2017 të dt. 17.10.2017 në shqyrtimin e hapur gjyqësor të mbajtur me datën 12.06.2018, në praninë e Prokurorit të shtetit Valdet Avdiu, përfaqësuesit të dëmturës DBPZHR - zyra në [REDAKTUAR] në Ferizaj [REDAKTUAR], të akuzuarit e dëshmitarit, mori dhe publikisht shpalli, kurse me dt.13.06.2018 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari, [REDAKTUAR], nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e Ferizajt, i lindur me [REDAKTUAR], në të njëjtin vend, nga i ati [REDAKTUAR] dhe e ëma [REDAKTUAR] e gjinisë [REDAKTUAR] i punësuar në Firmën [REDAKTUAR], ka të kryer shkollën fillore, i martuar baba i 3 fëmijëve, i gjendjes së varfër ekonomike, shqitpar, shtetas i Kosovës, *i denuar më parë për vepra të njehta penale,*

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datën 27.08.2017 rreth orës 18,00 në pyllin publik të cilin e menaxhon Drejtoria për bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural-zyra në Ferizaj, në Rajonin Ekonomiko-PyJOR në fshatin Neredime-Jezerc në vendin e quajtur "Firishta" me qëllim vjedhjeje me sharrë motorike ka prerë 2 copë dru ahu të njomë, me gjatësi 25 metra me diametër 40-45 cm., në vëllim 2.40 m³ të cilat i ka bartur me traktor dhe në vlerë dëmi prej 324.00 €.

me të cilën ka kryer veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par.1 të KPRK-së.

Gjykata në kuptim të nenit 358 par.1 të KPRK-së, dhe nenit 3,11, 17, 46, 47, dhe 73 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së, e

GJYKON

Me dënim në të holla në shumë prej 400 /katërqind / Euro, të cilat është i obliguar që ti paguaj në afatin prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyrat tjera të parapara nga nenin 46 par.3 të KPRK-së, gjykata do ta ekzekutoj aktgjykimin në atë mënyrë që të pandehurit për çdo 20 € të gjobës të vuaj në një ditë burgu.

Obligohet i pandehuri që të damtuarit- DBPZHR- zyra në Ferizaj në emër të kërkesës pasuroro-juridike të i bëjë kompensimin e dëmit në lartësi prej 324.00 €.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqsor të paguaj kësaj gjykate shumë prej 20 /njëzetë/ Euro, në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit –Ligji nr.05/L-036, Obligohet i akuzuari që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumë prej 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Arsy etimi

Prokuroria Themelore në Ferizaj ka ushtruar aktakuzën e vet PP/II Nr.1830-7/2017 të dt. 17.10.2017, kundër të akuzuarit [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] komuna e Ferizajt, për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni 358 par.1 të KPRK-së.

Gjykata, duke vepruar sipas akuzës së PTH-së në Ferizaj më datën 12.06.2018 ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor në të cilën Prokurori i shtetit Valdet Avdiu si në fjalën hyrëse, por edhe ate përfundimtare deklaroi: se ngel në tërësi pranë aktakuzës, i propozoj gjykatës që të nxjerrë provat e propozuara në propozim akuzë, dhe pas vlersimit të tyre i akuzari të shpallet fajtor dhe të i shqitpohet dënimi i parapar me ligj.

I akuzuari në shqyrtimin gjyqësor delaroi: se nuk e ndin vehtën fajtor për veprën penale e cila i vëhet në barrë, pra për veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par.1 të KPRK-së dhe shton se personalisht nuk e ka kryer veprën penale e cila i vëhet në barrë.

Gjykata, pasi që ka dëgjuar fjalën hyrëse të prokurorit të shtetit i cili në shqyrtim gjyqësor ka theksuar se do të vërtetohen faktet e veprës penale të vjedhjes për të pandehurin [REDAKTUAR] ku e dëmtuara është DBP- zyra në Ferizaj, e kjo do të vërtetohet në bazë të dëshmisë së dëshmitarit : [REDAKTUAR] roje pylli në DBP- zyra në Ferizaj -si dhe provat tjera të cilat gjinden në lëndë.

Përfaqësuesi i të dëmtuarës DBP-zyra në Ferizaj [REDAKTUAR], ka përkrahur në tërësi fjalën hyrëse të Prokurorit të shtetit sa i përket përgjegjësisë penale të pandehurit, kurse sa i përket kërkesës pasuroro – juridike ka paraqitur kërkesë për kompensimin e dëmit në lartësinë e shumës të cekur në propozim akuzë të PTH-së në Ferizaj në shumën prej 324.00 Euro.

Gjykata bëri zbatimin e provave: dëgjoj dëshmitarin – roje e pyllit pranë DBPZHR- zyra në Ferizaj, [REDAKTUAR]-roje pylli, i cili është edhe hartues i Procesverbalit e cila është provë përcaktuese në lëndën juridike dhe në shqyrtim gjyqësori deklaroi se : është e vërtet se të pandehurin [REDAKTUAR], më dt. 27.08.2017 rreth orës 18,00 e kam hasur personalisht në vendin e quajtur “Firishte” në pyllin shoqëror të APK në Ferizaj, pikërisht në

fshatin Jezerc duke bartur me traktor IMT-539 me krrabë dhe ate 2 copa dru të ahut të njomë, të cilin më parë e kishte prerë me sharrë motorike me gjatësi siq është përcaktuar në akuzë dhe , me diametër 40-45 cm, dhe unë të pandehurin e kam parë personalisht në vendin e ngjarjes, ndërkaq sasinë dhe vlerën e dëmit e ka caktuar Tekniku i pylltarisë dhe kjo është e vërtet se i njejt ditën kritike e ka dëmtuar pyllin shoqëror ashtu siq është paraqitur në fletëparaqitjen e rojës së pyllit, përfundon dëshminë e tij dëshmitari.

Përfaqësuesi juridik i të dëmtuarës DBPZHR- zyra në Ferizaj në emër të kërkesës pasuroro – juridike ka kërkuar kompensimin e dëmit në shumën prej 324.00 €

Gjykata, ka bërë paraqitjen e provave dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njërin me tjetrën, në kuptim të dispozitës ligjore të nenit 361 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së, vërtetohet gjendjen faktike të përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi dhe ka konstatuar : se me datën 27.08.2017 rreth orës 18,00 në pyllin publik të cilin e menaxhon Drejtoria për bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural-zyra në Ferizaj, në Rajonin Eonomiko-Pyjor në fshatin Neredime-Jezerc në vendin e quajtur “Firishta” me qëllim vjedhjeje me sharrë motorike ka prerë 2 copë dru ahu të njomë, me gjatësi 25 metra me diametër 40-45 cm,, në vëllim 2.40 m3 dhe në vlerë prej 324.00 €.

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar përmes provave të prezantuara në shqyrtimin gjyqësor dhe atë: vlerësimi dhe llogaritja e dëmit të pyllit nga fletëparaqitja për dëmtimin e pyllit e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, zyra në Ferizaj si dhe procesverbali me nr. 164/2017,numër protokolli 164/17 i dt. 29.08.2017 , dhe Procesverbali i dëmit të shkaktuar me numër dhe datë të njejtë, të gjitha këto janë pjesë përbërëse e shkresave të lëndës.

Konform nenit 133 par.8 të KPPRK-së, gjykata bëri ballafaqimin e të pandehurit me dëshmitarin dhe konstatoi se bindshëm thënjtet e dëshmitarit ishin sqaruese dhe të sakta e objektive, ndëraq thënjtet e të akuzuarit ishin bishtëruese me qëllim të ikjes nga përgjegjësia penale.

Duke vërtetuar gjendjen faktike gjykata konfirmon se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha elementet qensore të veprës penale vjedhje pylli nga neni 358 par.1 të KPRK-së, andaj, gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe në kuptim të dispozitave ligjore të

cituara në dispozitiv të aktgjykimit i shqiptoj dënim në të holla në shumën prej 900 Euro, i cili është i obliguar që dënimin e shqiptuar në të holla ta paguaj në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmëris së aktgjykimit.

Gjykata çmoj dhe vlersoj mbrojtjen e të akuzuarit se kinëse ai personalisht nuk ka ndërmarr veprimin e dëmtimit të pyllit, dhe se në këtë bazë kinëse nuk ekziston fajësia, pasi që nuk është provuar se ka kryer vepër penale dhe se nga pylltarët është zënë dikush tjetër edhe nuk janë këto shenimet e mia të sakta dhe se ai personalisht nuk i ka prerë, por i ka prerë dikush tjetër.

Gjykata tezën mbrojtëse të propozuar nga i pandehurit nuk e ka pranuar si të bazuar nga pohimet e tij dhe se Procesverbali i hartuar nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim rural zyra në Ferizaj, është provë e pranueshme, por edhe Procesverbali i dëmit të shkaktuar me numër dhe datë të njejtë, por edhe deklaratat e dëshmitarit në tërësi e vërtetojnë gjendjen faktike e paraqitur në akuzë dhe besimin gjykata ia fali dëshmitarit. Ndërkaq, gjykata konsideron se mbrojtjen i pandehuri e ka bërë me qëllim të shmangëjes nga përgjegjësia penale duke i kundërshtuar deklaratat e dhëna nga ana e dëshmitarit.

Gjatë shqiptimit të dënimit në kuptim të nenit 73 të KPRK-së gjykata pati parasysh rrethanat lehtësuese dhe randuese, si rrethana lehtësuese gjykata pati parasysh faktin se i akuzuari është punësua me ë ardhura të vogla, baba i tre fëmijëve, dhe i gjendjes së varfër ekonomike.

Si rrethana tjera rënduese gjykata pati parasysh shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës së kryer, e ato janë: *se është recidivist i këtyre llojeve të veprave penale dhe i denuar edhe më parë me aktgjykim të formës së prerë nga ana e kësaj gjykate dhe se ka edhe procedura tjera penale për të njejtat vepra penale në këtë gjykatë.*

Ndërsa, rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti. Gjykata të pandehurit i shqiptoj një dënim me gjobë duke marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale duke i caktuar dënim me gjobë të paraparë me nenin 46 par.4 të KPRK-së, me të cilin dënim do të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës speciale dhe asaj gjenerale i paraparë me nenit 41 të KPRK-së.

Konform nenit 458-463 të KPPK-së obligohet i akuzuari që DBPZHR-Zrya në Ferizaj në emër të kërkesës pasuroro – juridike të i kopmensoj dëmin e shkaktuar në shumën prej 324.00 €.

Konform nenit 454 par.1 të KPPRK-së i akuzuari obligohet në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqsor të paguaj kësaj gjykate shumënprej 20 /njëzet/ Euro,në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së katgjykimit nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit –Ligji nr.05/L-036, Obligohet i akuzuari që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Nga arsyet e sipërcekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.


GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,

P.nr.2580/17 të dt. 12.06.2015.

**Procesmbajtësen,
Liridona Mehmeti**

Gjyqtari

Elmaz Zenuni



KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 dite, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa dorzohet nëpërmes kësaj gjykate.